



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:135685

Datë: 03.07.2024

Numri i dokumentit: 05893460

P.nr.251/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit M.L nga Kaçaniku, i akuzuar për veprën penale, Keqpërdorim I besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.968-6/19 të datës 19.06.2019 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.26.06.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Dardan Çela dhe të pandehurit në mungesë të përfaqësuesve të të dëmtuarve, me dt.0128.06.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt. 03.07.2024 dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.L nga Kaçaniku, i lindur më dt..., nga i ati R... dhe e ëma Sh..., e gjinisë E..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind I pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse ndërmjet datës 03-04 Maj 2019 dhe 05-06 Maj 2019 në fsh. Semajë, Komuna Kacanik saktësisht në punishten e gurëthyesit "...", i pandehuri nuk i ka përmbushur detyrimet e tij, që i ka patur ndaj kompanive: ... SH. P. K , ... SH.P.K dhe T...B.I, në atë mënyrë që gjatë natës e ka lëshuar vendin e punës dhe në mjetet e punës së ketyre kompanive ka patur humbje të naftës, dhe atë në makinen shpuese të kompanisë Tropikana B.I 280 litra, në ekskavatorin e kompanise ... SH.P.K , RH 6-5 -80 litra dhe në ekskavatorin e kompanise ... SH.P.K, Liber 932-60 litra, me ç'rast i ka shkaktuar dem të dëmtuarës T... BI ne vleren prej 313 €, të demtuarit ... ne vlerën prej 80 € dhe te dëmtuarit në vlerën prej 67 € .

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën penale, Keqpërdorimi i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,48,69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

Me dënim me kusht me të cilin i vërtetohet dënimi me gjobë prej 450.00 € dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë veprë tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30.00€, ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit në shumë prej 20.00€, te gjitha keto paguhen në afatin prej 30 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të dëmtuarat... Shpk, ... Shpk dhe T... B.I, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.968-6/19 të datës 19.06.2019, të pandehurin M.L nga Kaçaniku, e ka akuzuar për veprën penale, Keqpërdorimi i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.06.12.2019 me te cilin rast, I pandehuri , pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori I shtetit, nuk e ka pranuar plotësisht fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqesor të mbajtur më 26.06.2024, prokurori I shtetit Dardan Çela, me rastin e prezentimit të aktakuzës, mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

Përfaqësuesit e të dëmtuarve nuk kanë qenë prezent në shqyrtimin gjyqësor.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shtuar se për kohën për të cilën bëhet fjalë, është e vërtetë që ka qenë i autorizuar që të ruaj mjetet e këtyre tri kompanive, por meqë nuk ka patur ndonjë hapësirë të veqantë se ku të qëndrojë, por ka qenë në qiell të hapur, e pranon që e ka lëshuar vendin e rojes dhe pranon që ka patur vjedhje të naftës nga mjetet e këtyre tri kompanive, për çka shpreh keqardhje dhe i premtom gjykatës qe veprime te tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen. I njëjti poashtu ka theksuar se nga ky rast më nuk ka punuar për këto kompani, edhe pse pronari I kompanisë “...” e kishte falur, dhe meqë është hera e parë që gjykohet për nje vepër penale, njëherit edhe i kërkon gjykatës që duke patur parasysh edhe gjendjen e dobët ekonomike, të gjitha këto të merren parasysh me rastin e marrjes së vendimit .

Prokurori i shtetit ne fjalen e tij nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit meqë i pandehuri e kuptoi natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri, pranimi i fajësisë gjithashtu ka mbështetje në faktet dhe provat qe i përmban aktakuza si dhe gjithashtu aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Prandaj i propozon gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 322 lidhur me 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike andaj shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Prokurori I shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, nga vetë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili vullnetarisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv. Andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanat rënduese ashtu edhe lehtësuese, ku si rrethanë rënduese të merr parasysh shkallën e përgjegjesisë penale dhe rrethanën nën të cilën është kryer vepra penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar si dhe faktin se i pandehuri është i moshuar. Gjithashtu konform nenit 61 të KPRK-s, prokurori I shtetit i propozon gjykatës që krahas dënimit kryesor t'i shqiptojë edhe dënimin plotësues, urdhërin për kompensimin e humbjes apo dëmit .

I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se nuk ka diçka tjetër për të shtuar përveç asaj që e ka thënë me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Keqpërdorimi i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, moshën e vjetër të tij dhe faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës I njejtë nuk ka patur raste të tjera penale të kësaj apo natyre tjetër penale, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata nuk gjeti, përveç veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elemente të veprës penale, për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.L, i akuzuar për veprën penale, Keqpërdorimi i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
P.nr.251/19 datë 03.07.2024

Sekretarja juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.